

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-25-5811-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me kushineta ; Lot.1-Furnizim me kushineta për mullinj ; Lot.2 Furnizim me kushineta standarde për TCB ; Lot.3 Furnizim me kushineta të ndryshme dhe hilzne për DPQ**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" GiGi " SH.P.K.
NUI	810158023
Adresa	Gani Demolli No.12
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	045695555
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Feime Makolli
Adresa elektronike	gigishpk@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.11.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot.1-Furnizim me kushineta për mullinj][Lot.3 Furnizim me kushineta të ndryshme dhe hilzne për DPQ

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me “Titulli: Furnizim me kushineta ;

Lot.1-Furnizim me kushineta për mullinj ;

Lot.2 Furnizim me kushineta standarde për TCB ;

Lot.3:Furnizim me kushineta të ndryshme dhe hilzne për DPQ” dhe njoftimi për kontratë është bërë me datën 27.06.2025.

Afati i fundit për ofertim ka qenë i caktuar për datën 18.08.2025. Hapja publike është bërë në kohën dhe vendin e paraparë. Letren Standarde per tenderuesin e eliminuar e kemi pranuar me datën 23.10.2025, dmth pas 2 muajve 5 dite duke filluar nga hapje e ofertave.

Kriteret e Dhënies - Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Kerkesen per Rishqyrtim e kemi derguar tek Ak-es me daten 28.10.2025.

Pergjigjen ndaj Kerkeses per Rishqyrtim nga AK-es e kemi pranuar permes platofomes elektronike me daten 30.10.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Kerkesen për Rishqyrtim e kemi derguar tek Ak-es me datën 28.10.2025.

Pergjigjen ndaj Kerkeses për Rishqyrtim nga AK-es e kemi pranuar përmes platformës elektronike me datën 30.10.2025

AK-es nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë lidhur me faktet të cilat ne i kemi prezentuar në Kerkesen për Rishqyrtim dhe ka perseritur të njëjtin vendim duke na hedhur si të pabazuara faktet tona. Andaj sot ne bëjmë ankese tek ju në OSHP si instance me e lartë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjërë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka shkelur Ligjin me nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Gjatë procesit të vlerësimit AK ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar.

AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar.

AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar.

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së Nr. 04/L-042 të amendamantuar

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

LOT 1

AK-es në Letren Standarde për tenderuesin e eliminuar për LOT 1 ka shkruar

“ Edhe pas Kthimit të përgjigjeve nga OE, komisioni teknik prap vie në përfundim se ky OE është teknik i pa përgjegjshëm pasi që ka hartuar katalog dhe link vetëm për AK dhe enkas vetëm për aktivitet të prokurimit, por ende nuk ka dëshmuar se prodhuesi i ka në katalog dhe program të prodhimit kushinetat sipas kërkesave tona. Këto janë prodhime standarde dhe secili prodhues që prodhon kushineta e ka katalogun me të gjitha kushinetat që i prodhon ku në katalog janë edhe të gjitha të dhënat e performancës së kushinetës. Kjo është shumë e thjeshtë. Nuk ka arrit të dëshmoj performancën e kushinetave.”

Ne si OE kemi ofruar ofertën në përputhje m DT-it. Në DT-it si kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë kërkuar :

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Çertifikatat e prodhuesit sipas :

a) ISO 9001 2015

b) Certifikata e konfirmimitit CE

Vlen per tri (3) lotet e tenderit

2.Dokumentacioni i prodhuesit si katalogë pjese të katalogut ose viz. teknike të prodhuesit me përshkrime teknike detale për artikujt qe ofertoni.

Vlen per tri(3) lotet e tenderit

Ne kemi ofruar edhe për këto LOT-1 ISO 9001:2015, Çertifikatën e konformitetit CE e cila ka qene obliguese nga ju në fazën e ofertimit dhe Katalogun për secilin artikull duke përfshirë në detale specifikimin teknik te çdo kushinete të ofruar nga prodhuesi.

Më datën 19.09.2025 kemi pranuar nga AK-es LS të kërkesës për sqarimin e tenderit me këto kërkesa *“Në faqen e prodhuesit askund nuk ka katalog për ta vërtetuar performancën e kushinetës. Pyetje sqaruese për OE ju lutem na dërgoni linkun e katalogut të prodhuesit me qëllim të vërtetimit të performancës së kushinetave dhe dëshmi se prodhuesi i ka në program të prodhimit kushinetat me performancat e kërkuara. Kjo për shkak se katalogu i paraqitur në ofertë nuk është katalog origjinal i prodhuesit, por janë përshkruar kërkesat tona dhe është vendosur logoja e prodhuesit”*

Pasi pranuar kërkesën e AK-es për sqarim e njoftuam prodhuesin dhe ai na solli një deklaratë ku sqaroi në hollësi për gamën e prodhimit që kanë duke përfshirë nga kushinetat standarde deri të ato sipas porosive të klientëve ,ku ndër to janë edhe këto kushineta shume specifike të cilat kërkojnë të punojnë 100000 h/pune. Të njëjtën

deklaratë të prodhuesit me deklaratën tonë sqaruese ju kemi dërguar AK-es edhe pse kjo kërkesë e AK-es bënte shkelje të LPP-së sepse nuk guxon asnjë AK-es të krijoj kërkesa të reja që nuk i ka përcaktuar në DT-it dhe vlerësimin duhet të bën vetëm mbi ato kërkesa që janë në DT-it. Përkundër kesaj AK-es prap ka refuzuar ofertën tonë dhe na ka eliminuar nga kjo procedure e aktivitetit per LOT-1.

Fare thjesht mund te ju sqarojmë edhe tani në këtë ankesë për shkeljen e LPP-së që AK-es ka bërë konkretisht nenit 59,paragrafit 4 ku thuhet *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...”*

AK-es nuk mund të lidhet apo thirret në faqen e prodhuesit për te refuzuar ofertën tonë, siç nuk mund të spekulojë që katalogu me të cilin kemi ofertuar nuk është katalog i prodhuesit. Faqja e internetit ku tregohet që HGF është prodhues është faqe në domenin e prodhuesit dhe ai vendos dhe fshin çkado nga faqja e tij sepse është çështje private dhe biznese e autentike e tij. Dëshmi që është prodhues janë certifikata ISO 9001:2015 valide , certifikata e konformitetit CE dhe katalogjet qe ju ka ofruar enkas per këtë aktivitet te stempuara direkt nga prodhuesi. Nëse AK-es pasur dyshime lidhur me të dhënat në katalog atëhere ka mundur ti shkruan direkt prodhuesit ,por kurresesi nuk guxon të thotë që katalogjet e prodhuesit nuk janë origjinale. Ne kemi parë edhe në çasje që ZP-ja ka ndar mendimin nga anëtarët tjerë të vlerësimit sepse ZP-ja e din që nuk guxon të refuzohet një ofertë e kompletuar dhe e përgjegjshme nën dyshime apo me kërkesa që nuk janë në DT-it dhe në njoftimin për kontratë. Ne besojmë që ZP-ja është dashur të ju sqaroj anëtarëve tjerë për këtë shkelje dhe të njoftojë ZPP-së për shkeljet e anëtarëve tjerë.

AK-es ka shpërblyer me kontratë OE ELPROJEKT SHPK i cili nuk është i përgjegjshëm.

OE ELPROJEKT SHPK ka ofruar dy *Çertifikata të konfirmimitit CE dhe asnjëra nuk janë për kushineta dhe asnjëra ska datë të skandencës. Aty ku shkruan Type of equipment tregon për çfarë artikujsh ose sherbimi përdoret ajo çertifikate konformiteti ,dmth nuk jane certifikata CE për kushineta thjeshtë dhe nuk është dashur të jenë pjesë e ofertës .Përmes këtyre dy çertifikatave që njëra është për “3G Sensor for Railway Application” dhe tjetra “OE ELPROJEKT SHPK Condition Monitoring On-Line System” është **mashtuar komisioni vlerësues dhe e ka marr si kërkesë të plotësuar për OE ELPROJEKT SHPK. Ne do t’ja bashkojmë ankesës këto dy dokumente.***

Për LOT 3

Lidhur më Lot 3 ne si OE GiGi SHPK nuk kemi eliminuar si te papergjegjshem por AK-se keni shpërblyer me kontratë OE ELSAM SHPK.

Ne si OE GiGi shpk mendojmë dhe besojmë që OE ELSAM SHPK është i papërgjegjshëm për këto arsye:

Në DT-është kërkuar që Çertifikata ISO 9001 :2015 , Çertifikata CE dhe Katalogu te jenë

të një prodhuesi , por jo për artikullin e njëjtë të përdoret ISO 9001 e prodhuesit SHY BEARING LTD , brendi SRG me autorizim të një prodhuesi tjetër Changzhou HSH Machinery Co.,LTD. Do duhet të ishte ISO -ja, CE-ja dhe Katalogu nga prodhuesi

SHY BEARING LTD ose nga prodhuesi HSH Machinery Co.,LTD. Por jo nga të dy.

Siç ju e dini kur vendoset QR CODE në ndonjë certifikatë ju mund ta lexoni apo vërtetoni në çdo kohë validitetin e asaj certifikate. Ne rastin e ELSAM SHPK i cili ka ofruar një certifikate ISO 9001 me QR CODE të prodhuesit SHY BEARING LTD ,nëse e skenoni dhe i futni të dhënat e certifikatës (emrin dhe numrin e certifikatës) do të shihni që nuk rezulton asnjë gjë dhe kjo i bie që në këtë certifikatë është ndërhyrë apo është falsifikuar dhe AK-es mundet me shumë lehtësi me vërtetu këtë gjë duke ju shkruar agjension që ka lëshuar këtë certifikatë apo edhe duke skenuar QR CODE që është i vendosur në Certifikatën ISO 9001:2015 të ofruar nga ELSAM SHPK(do tja bashkojmë këtë certifikatë ankesës sonë).

ELSAM SHPK ka ofruar nje deklarate të konformitetit por jo certifikate të konformitetit CE, të vulosur nga prodhuesi jo valid SHY BEARING LTD. Dmth nuk ka ofruar certifikate të konformitetit me të cilën pajisen prodhuesit për mallin specifik, e jo siç është munduar ELSAM SHPK të kamuflojë përmes një deklarate që do të mbulojë këtë aktivitet. Nuk ka certifikate konformiteti për këtë apo atë aktivitet.

Pastaj Katalogu është plotësisht në shpërputhje me kërkesat e DT-it. Gjithsej për lot 3 janë kërkuar 76 pozicione. Për 28 Pozicione nuk është ofruar fare specifikim teknik. Për 46 pozicione nuk është ofruar specifikimi teknik siç kërkohet në DT-it ndërsa vetëm për 2 pozicione ka ofruar specifikim ne katalog ashtu siç eshte kerkuar nga AK apo DT-it. Këtë dëshmi do tja bashkoj ankesës dhe dokumentin do ta emroj “Mungesat në katalogun e prodhuesit SRG te ELSAM SHPK”. Ne jemi të brengosur se si ka mundur një komision vlerësues me shpërblyer me kontratë një OE ELSAM SHPK i cili ka ofruar specifikim vetëm për 2 nga 76 pozicione në përputhje me kërkesat e DT-it. Ne Lusim OSHP-në që seriozisht të mirret me këtë komision dhe ti shoh tendencat e tyre për këtë lloj vlerësimi.

Oferta jonë është oferta me çmim më të lirë nga ofertat e përgjegjshme për LOT 1 dhe LOT 2 ,prandaj është obligim i Autoritetit kontraktues që të zbatoj kriterin e dhënies së kontratës për këtë aktivitet të prokurimit dhe lenda të kthehet në rivlerësim dhe të na shpërblej me kontratë.

Prandaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të ankesës tonë dhe verifikimit të fakteve të ofruara si dhe çdo herë duke u mbështetur në parimet dhe dispozitat e LPP-së, të marrë:

VENDIM

-

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “ **GiGi SHPK** ” nga Prishtina lidhur me tenderin “**Furnizim me kushineta**” i iniciuar nga **KORPORATA ENERGIJETIKE E**

KOSOVES sh.a.

ANULOHET vendimi i AK- **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.** për dhënjen e kontratës dhe lenda të kthehet në rivlerësim e kjo të bëhet duke u bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dipozitat e LPP-së

AK-es për LOT 1 ,ka kërkuar dy tipe të kushinetave dhe për dy tipet ka kërkuar që të punojnë kështu:

Për Kushinetën e parë 23252 CACK/C3 W33 , ka kërkuar në bazë të specifikimit në DT-it që të punojë 100000 h/pune me rrotullime për minutë si reference prej 850 r/min deri te maksimumi 1200 r/min dhe me ngarkesë dinamike minimale (Basic dynamic load rating): 3 395 kN ndersa

Për Kushinetën e dytë **23284 CAK/C3 W33** ka kërkuar në bazë të specifikimit në DT-it që të punojë 100000 h/pune me rrotullime për minutë si reference prej 450 r/min deri te maksimumi 630 r/min dhe me ngarkesë dinamike minimale (Basic dynamic load rating) C= 7 677 kN. OE ELPROJEKT SHPK ka ofruar nje dokument në formë deklarate të vulosur dhe nënshkruar nga SKF EURO TRADE AB (ja bashkojmë ankesës) ku garanton që këto dy tipe të kushinetave punojnë 100000 h/pune por me shpejtesi 100 r/min. Kjo deklarate e ofruar nga SKF EURO TRADE AB si prodhues i kushinetave tregon qartë se këto kushineta nuk mund të punojnë 100000 h/pune më shpejtesin si reference 850 r/min për kushinetën e parë dhe me shpejtësin si reference për kushinetën apo pozicionin e dytë 450 r/min. Dmth OE ELPROJEKT SHPK me deklaratën e SKF EURO TRADE AB ka dëshmuar që nuk mund të garantojë që kushinetat e kërkuara janë në përputhje me kërkesat në aneksin 1 specifikimet e detyrshme dhe më këtë deklaratë i ka ikur garancionit që ato mund të punojnë 100000 h/pune me shpejtesin siç kërkohet ne DT-it ,por kuresesi vetëm 100 r/min.

OE ELPROJEKT SHPK në deklaratën për garancion ka shkruar “Deklarojmë se Garancioni 24 muaj nga data e montimit apo 36 muaj pas pranimit teknik”, për ne ky 24 muaj nga data e montimit apo 36 muaj pas pranimit teknik paraqet variant dhe variantet nuk lejohen sipas DT-it.

Ju lutem ti merrni parasysh gjetjet tona për Lot 1 dhe të ktheni në rivlerësim. OE ELPROJEKT SHPK të eliminohet si i papërgjegjshëm dhe ne të shpërmblemi me kontratë si OE i vetëm më i lirë dhe i përgjegjshëm për Lot 1.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jonë është dëmtuar për shkak të krijimeve të shpenzimeve të bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, të përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim dhe nga fitimet e pritura si dhe dëmtimit të imazhit përmes spekulimeve të AK-së për gjëja mashtrimeve më dokumentacion të prodhuesit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*